



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 9.2.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq dhe Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.1.2016,
3. Shqyrtimi për shpalljen e konkursit në ZRRUK,
4. Shqyrtimi i shkresës nga komisioni për legjislacion,
5. Te ndryshme .

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa verejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.1.2016

Procesverbali 28.1.2016 u miratua pa verejtje.

3. Shqyrtimi për shpalljen e konkursit në ZRRUK

Kryetari i Komisionit njoftoi për Ligjin rreth Autoritetit për shërbimet e ujit i cili ka hyrë në fuqi dhe tani menjëherë duhet komisioni të veprojë me shpalljen e konkursit për drejtor dhe zëvendës drejtor në këtë autoritet, ndaj **u vendos** që të veprojë sipas ligjit, të shpallet konkursi dhe ashtu me radhë si kërkohet sipas këtij Ligji.

4. Shqyrtimi i shkresës nga komisioni për legjislacion

Kryetari i Komisionit falënderoi për pjesëmarrje të Avokatit të popullit **Hilmi Jashari** të cilit fillimisht ja dha mundësinë e sqarimit të kërkesave që ka bërë lidhur me Nenin 35 të Ligjit për Shpronësimin në të cilin nën duhet të bëhen ca ndryshime, ai potencoi :

- Fillimisht ju njoftoi se stafi i komisionit që ka njoftuar për Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese rreth Nenit 35 të Ligjit për Shpronësime ka të bëjë me diçka tjetër e jo për këto çështje që në diskutojmë sot, në fakt ka të bëjë me nivelin e vendosjes lokale dhe qendrore,
- Sa i përket vërejtjeve nga Institucioni i Avokatit të popullit lidhur me Nenin 35 potencoi se është nonsens të mbeten paragrafet e apostrofuara të Nenit 35 të Ligjit për shpronësime, ngase bëhet fjalë për shkurtime serioze të drejtave pronësore përmes afateve apo gjërave të tilla procedurale,
- **Afrim Murati-MMPH** pajtohem se Paragrafi 8 mund të formulohet ndryshe ngase bëhet fjalë për pengesa teknike dhe jemi për shpejtimin e procedurave të shpronësimit,
- **Av. i Popullit** : Nuk ka çështje teknike në Ligj, të gjitha janë përmbajtësore, dmth nuk duhet me lënë vend për arbitraritet,
- **Shaip Muja** nuk ka diskutim për pronësi sepse ne jemi si komision kompetent, mirëpo këtu kemi çështje tjera ligjore që involvon edhe komisionin për legjislacion, ndaj të formojmë një grup punues dhe ti ftojmë aty të gjithë që duhet të marrin pjesë dmth edhe antarë nga komisioni për legjislacion,
- **Av. i Popullit** : një gjë të sigurt mund të ju konfirmoj se ata të Legjislacionit në mbledhjen e mbajtur ku kam qenë edhe unë prezent, menjëherë janë pajtuar se duhet të veprojë me ndryshime, por pasi nuk kishin kompetencë për fushëveprimin u dërguan vërejtjet në këtë komision,
- **Stafi i komisionit** : në kohën e UNMIK-ut nuk ka funksionuar MMPH me departamentin për shpronësime, ndaj këtij komisioni i takon tani të veprojë me

ndryshime ose të kërkoi nga MMPH ti bëjë këto ndryshime, duke ndryshuar ligjin me një ligj tjetër,

- **Adem Salihaj** : të presim mbledhjen e radhës dhe të konsultohemi si duhet të vepron ky komision,
- **Murat Hoxha** : ky komision e ka funksionalitetin për këtë fushë,
- **Fikrim Damka** : Legjislacioni ka dërguar këtu te ne, kurse na prapë me ju kthye atyre nuk bënë, ndaj të shohim si do të veprojmë, arsyeshme do të ishte MMPH ta merr barrën, ndaj kërkojmë mendimin e juaj të nderuar zyrtarë të MMPH,
- **Servet Spahiu-drejtor i departamentit për shpronësime** : kemi të bëjmë me një ligj i cili më së tepërmi zbatohet në praktikë, mirëpo nëse kërkojmë përgjigje të sakt , iniciativën do të ishte ma mirë të bëni ju, ngase ne zyra ligjore në MMPH merremi me gjëra të përditshme dhe këto ne nuk i bëjmë,
- **Emilija Redzeqi** : kompetencë e këtij komisioni është, natyrisht me pjesëmarrjen edhe të Legjislacionit,
- **Murat Hoxha**: nuk po kuptoj z. Drejtor, si është e mundur ju të dini çdo gjë nga praktika ndërsa nuk bëni iniciativën për ndryshime, madje ndryshime serioze, ose pse ne ta bëjmë këtë,
- **Fikrim Damka** : sot po e përmbyllim me kaq por deri në mbledhjen e radhës duhet të gjejmë një solucion, ju ftoj në konsultime bashkë me stafin deri në mbledhjen e radhës më 16 shkurt.

5. Të ndryshme

Shaip Muja kërkoi nga Kryetari lidhur me Projektligjin për Obiliqin se duhet të veprohet disi , ose të përmbyllet ose të tërhiqet , ndaj sugjeroi të dërgohet shkresa e tij në Qeveri ose gjetiu dhe të pritët një përgjigje.

Fikrim Damka u pajtua se patjetër duhet të veproji komisioni , ngase një zgjidhje duhet të ekzistoi, ndaj shkresa duhet të përgatitet deri në mbledhjen e radhës.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka